


euprogres ▶▶

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Raporti i katërt tremujor

1 tetor – 31dhjetor, 2011.



Program finansira EU

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



 UNOPS

Sprovodi program



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu progres

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Përmbledhje

Fundi i këtij tremujori ka shënuar edhe gjysmën e periudhës së implementimit të EU PROGRES-it, kurse duke pasur parasysh ofrimin e zgjedhjeve në vitin 2012, është e qartë se do të materializohen rreziqet e parashikuara në dokumentin e Programit. Zyrtarët komunal kanë filluar të përdorin projektet e infrastrukturës për promovim të vetin/partiak përderisa arritja e konsenzusit për iniciativat e caktuara është gjithnjë e më e vështirë.

Lajm i mirë është se marrëdhënia në mes të mjeteve të kontraktuara dhe të shpenzuara është përmirësuar: janë shpenzuar 3,1 nga 6,9 milion euro, që janë kontraktuar deri më tani, me çka pjesa e mjeteve të shpenzuara është rritur në 44% nga 22%, sa ka qenë në gjysmën e vitit 2011.

Shumica e projekteve të financuara përmes Fondit për pjesëmarrje qytetare (CIF) zbatohet sipas planit dhe tanimë ka dhënë rezultate të mira. Janë nënshkruar kontratat për dy shërbime këshilldhënëse për qytetarët (GSS), në Zhitragjë dhe në Prokuple, përderisa projekti të cilin e zbaton DamaD jep rezultate të mira përkundër disa problemeve të vogla administrative: p.sh. duke iu falënderuar lobimit të DamaD edhe Rashka dhe Sjenica kanë hapur linja buxhetore për aktivitetet lidhur me barazinë gjinore.

Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Komponentës 2 po zgjerohet gjithnjë e më shumë, dhe me tempo të barabartë me të cilin po zbatohen projektet lidhur me përgatitjen e dokumenteve planore dhe atyre lidhur me themelimin e qendrave të asistencës për qytetarët (QAQ), fillon zbatimi i aktiviteteve që sigurisht do të sjellin deri tek përmirësimi i situatës ekonomike në komunat e përfshira në Programin EU PROGRES, siç janë qendrat e inkubatorëve të biznesit (BIC) në Vranjë dhe në Prokuple.

Suksesi më i madh i arritur në kuadër të Komponentës 3 është nënshkrimi i kontratës për themelimin e Zonës së gjelbërt në Leskoc me vlerë gjysmë milioni euro, i cili potencialisht do të sjellë deri tek hapja e qindra vendeve të punës në tërë Serbinë e Jugut. Tenderi publik është zbatuar pa kurrfarë problemi dhe ka rezultuar me ndarjen e kontratës në kuadër të mjeteve të disponueshme. Këshilli drejtues i Programit (KDP) në takimin e vet të tetorit ka aprovuar financimin e pesë projekteve të vogla shtesë të infrastrukturës.

Konkursi i vizatimit për kalendarin e EU PROGRAM-it, aktivitetet e organizuara në kuadër të Komponentës 4, tradicionalisht ka kontribuar në vizibilitetin jo vetëm të Programit, donatorëve të vet dhe të vlerave, por edhe në promovimin e ideve të cilat i kanë ilustruar garuesit. Tema e garës së këtij viti ka qenë Serbia si udhëkryq i kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Përveç kësaj, është arritur përparim shtesë në kampanjat për menaxhimin e mirë, kurse në vazhdim e sipër është edhe përshtatshmëria e Programit për realizimin e aktiviteteve të cilat përbëjnë menaxhimin e mirë si temë të tërthortë e që e financon Zvicra dhe që janë paraparë me Kontratë nga tetori i vitit 2011. Përgatitjet për punë në hartimin e planeve për brendim kanë ecur mjaft, me çka është vendosur bazë e fortë për realizimin e tyre nga fillimi i vitit 2012.

Ky raport ka për qëllim që të theksojë informatat kryesore për aktivitetet e Programit si dhe të tregojë disa faktorë të cilët do të mund të ndikojnë në zbatimin e tij. Në Kapitullin 1 është dhënë pasqyra e qëllimeve, synimeve, rezultateve dhe shfrytëzuesve. Në Kapitullin 2 janë shprehur informatat më të reja për ndodhitë më të reja politike, shoqërore dhe ekonomike, në fushën e përgjegjësisë (FP) e Programit. Pasqyra detale e aktiviteteve të Programit nga tetori deri në dhjetor të vitit 2011 është dhënë në Kapitullin 3, përderisa Kapitulli 4 është përqendruar në çështjet administrative lidhur me punën e EU PROGRES-it. Kapitulli 5



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNOPS

Sprovodi program

eu**progres** ▶▶

Program evropskog partnerstva sa opštinama

përmban pasqyrën e partneritetit të cilave i ka kontribuar Programi. Kapitulli i fundit, Kapitulli 6 ofron informata për vizibilitetin e Programit. Në Anekset e Raportit janë paraqitur informata të detajuara për aktivitete konkrete të ndërmarra në kuadër të Programit.